



## LISTA KONTROLLUESE E PUNËDHËNËSIT PËR VETËVLERËSIM

<b>PJESA 2:</b>	RREZIQET NË PUNË
<b>Tema 2.1.</b>	RREZIQET FIZIKE
<b>Nën-tema 2.1.4.</b>	<b>DRIDHJA</b>
<b>Ligji / rregulloret përkatëse:</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Ligji Nr.04/L-161/2013 për sigurinë dhe shëndetin në punë;</li><li>• Rregullore (MPMS) Nr.01/2017 për mbrojtjen e të punësuarve nga rreziqet lidhur me dridhjen në vendin e punës;</li><li>• Rregullore (MPMS) Nr.02/2021 për vlerësimin e riskut në vendin e punës.</li></ul>
<b>Shkurtesa:</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>• MPMS - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale</li></ul>
<b>Fushëveprimi i listës kontrolluese:</b>	Kjo listë kontrolli është e zbatueshme në të gjitha industritë dhe sektorët nën fushën e zbatimit të Ligjit Nr.04/L-161 për "Sigurinë dhe Shëndetin në Punë", pavarësisht nga forma e organizimit, lloji i pronësisë dhe arsytet mbi të cilat puna ose trajnimi kryhen në vendet e punës ku ekziston rrezik për shëndetin për shkak të dridhjeve.
<b>Përdorimi i listës së kontrollit:</b>	Nëse përgjigjeni "Po" në një pyetje, ju lutemi kaloni në pyetjen tjetër, në rast se përgjigjeni "Jo" bëni vërejtje që mund të ndërmerren veprime për të përmbushur kërkesat ligjore.

Nr.	Pika e kontrollit	Po	Jo	Vërejtje për zbatim
	<b>PARA VIZITËS NË LOKACION / VENDET E PUNËS</b>			
	<i>* Meqenëse bëhet fjalë për vetë inspektim, apo vetëvlerësim të situatës në subjektin tuaj nga rreziqet fizike – dridhja, do të ishte mirë që ekipi i inspektimit paraprakisht ta ketë në shqyrtim dokumentin e vlerësimit të riskut, atëherë do të ketë njohuri të afërta me rreziqet dhe masat e përcaktuara, të cilat duhet apo është dashur të ndërmerren nga punëdhënësi për mënjanimin, respektivisht minimizimin e tyre.</i>			
	<b>INSPEKTIMI I LOKACIONIT / VENDEVE TË PUNËS</b>			
	<i>* Gjatë vizitës në vendpunishte / vendin e punës, duhet t'i kushtoni vëmendje të punësuarve që janë të ekspozuar në vende të punës me dridhje duke i vëzhguar, duke u përgjigjur në pyetjet e përpiluara, duke vëzhguar duke bërë matje dhe duke fotografuar.</i>			

	<p><i>* Bisedoni me të punësuarit, tregohuni miqësor, shpjegoni dhe këshilloni për të drejtat e tyre sipas legjislacionit.</i></p>			
1.	<p><b>A i plotëson ambienti i punës kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në punë lidhur me dridhjen?</b></p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.01/2017, Neni 4</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Ekipi për inspektim del në objektin ku zhvillohet veprimtaria dhe bënë shikimin e ambientit të punës, merr në shqyrtim dokumentacionin e matjeve të nivelit të dridhjes dhe bisedon me disa nga punonjësit lidhur me kushtet e punës.</i></li> </ul>			
2.	<p><b>A i tejkalon mjedisi i punës vlerat kufitare të sigurisë dhe shëndetit në punë në lidhje me dridhjet për gratë shtatzëna?</b></p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.01/2017, Neni 4, 1.2 dhe 2.2</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Ekipi i inspektimit i merr të dhënat nga shërbimi i burimeve njerëzore për gratë shtatzëna të ekspozuara ndaj dridhjes që tejkalon kufijtë e përcaktuar dhe vërtetohet se a i tejkalon mjedisi i punës kërkesat ligjore të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë në lidhje me dridhjen për gratë shtatzëna.</i></li> </ul>			
3.	<p><b>A i tejkalon mjedisi i punës vlerat kufitare të sigurisë dhe shëndetit në punë në lidhje me dridhjet për punëmarrësit e mitur?</b></p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.01/2017, Neni 4, 1.2 dhe 2.3 Ligji Nr.04/L-161, Neni 16.1</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Së pari ekipi i inspektimit i merr të dhënat nga shërbimi i burimeve njerëzore lidhur me moshën e personave të mitur të ekspozuar ndaj zhurmës që tejkalon kufijtë e përcaktuar dhe vërtetohet se a i tejkalon mjedisi i punës kërkesat ligjore të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë në lidhje me dridhjen për të punësuarit e mitur.</i></li> </ul>			

4.	<p><b>A kryhet vlerësimi i riskut në bazë të legjislacionit në fuqi një herë në vit, në rastet kur tregon se vlerat e veprimit të ekspozimit janë arritur ose tejkaluar?</b></p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.01/2017, Neni 5, 3.1</p>			
5.	<p><b>A kryhet vlerësimi i riskut në bazë të legjislacionit në fuqi çdo dy vjet nëse tregon se vlerat e veprimit të ekspozimit nuk janë arritur dhe 1/5 e vlerës kufitare të ekspozimit është tejkaluar?</b></p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.01/2017, Neni 5, 3.2</p>			
6.	<p><b>A merren në konsideratë në vlerësimin e riskut niveli, lloji dhe kohëzgjatja e ekspozimit, vlerat kufitare të ekspozimit, çdo pasojë në sigurinë dhe shëndetin e punëmarrësve dhe kërkesa të tjera të përcaktuara në rregullore?</b></p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.01/2017, Neni 5, 6 Rregullore (MPMS) Nr.02/2021</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Gjithmonë kur bëhet fjale për matjet dhe vlerësimin i riskut në vendin e punës lidhur me ekspozimin ndaj dridhjes, ato duhet të kryhen rregullisht sipas rregullave të përcaktuara.</i></li> </ul>			
7.	<p><b>A ruhen të dhënat e marra nga vlerësimi ose matja e nivelit të ekspozimit ndaj dridhjeve mekanike në formë të përshtatshme dhe të disponueshme për përdorim të mëvonshëm?</b></p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.01/2017, Neni 5, 7</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Paraprakisht kur pranohet dokumenti i vlerësimit të riskut në vendin e punës, duhet domosdoshmërisht të shikojë se a janë përfshirë edhe vendet e punës nga rreziqet e zhurmës, të përcaktuara në nenin 5 të rregullores.</i></li> </ul>			
8.	<p><b>A dokumentohet rregullisht vlerësimi i riskut, veçanërisht nëse ka pasur ndryshime domethënëse që e bëjnë atë të pavlefshëm,</b></p>			

	<p><b>apo kur rezultatet e mbikëqyrjes shëndetësore tregojnë se kjo është e nevojshme?</b></p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.01/2017, Neni 5, 7</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Zakonisht ndryshimet e dokumentit të vlerësimit të riskut bëhen kur ka remont, apo ndërrim të pajisjeve, pajisjet vendosen në objekt tjetër dhe në atë vend të punës ku ka pasur lëndime me pasoja të rënda.</i></li> </ul>			
9.	<p><b>A i përfshin vlerësimi i riskut masat e marra për shmangien apo zvoglimin e ekspozimit ndaj dridhjeve?</b></p> <p>Ligji Nr.04/L-161/2013, Neni 7, 1.3 Rregullore (MPMS) Nr.01/2017, Neni 6, 1</p>			
10.	<p><b>A është hartuar dhe zbatuar një plan i masave teknike dhe/ose organizative që ka për synim të zvogëlojë në minimum ekspozimin ndaj dridhjeve mekanike dhe rreziqeve të lidhura me to, në rastin kur vlerat e veprimit të ekspozimit të përcaktuara në Nenin 4 të rregullores Nr.01/2017 janë tejkaluar?</b></p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.01/2017, Neni 6, 2</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Ekipi i inspektimit duhet të konstatojë se a janë shënuar me shenja të përshatshme vendet e punës, ku ekspozimi ndaj dridhjeve arrin ose tejkalon vlerat e sipërme të veprimit të ekspozimit.</i></li> </ul>			
11.	<p><b>A i merr në konsideratë plani pyetjet sipas kërkesave të përcaktuara në rregulloren Nr.01/2017?</b></p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.01/2017, Neni 6, 2</p>			
12.	<p><b>Nëse konstatohet ekspozimi mbi vlerat kufi të ekspozimit, a janë siguruar kërkesat e mëposhtme?</b></p> <p>a) <b>veprime të menjëhershme për të reduktuar ekspozimin nën vlerat kufitare të ekspozimit</b></p>			

	<p><b>b) identifikimi i arsyeve pse ka ndodhur mbi ekspozimi</b>  <b>c) marrja e masave për të parandaluar çdo përsëritje</b></p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.01/2017, Neni 6, 3</p>			
13.	<p><b>A u janë dhënë të gjithë të punësuarve të cilët kanë gjasa të ekspozohen ndaj rreziqeve të dridhjeve mekanike në punë informacione, udhëzime dhe trajnime të përshtatshme dhe të mjaftueshme për mënyrën se si të mbrojnë shëndetin e tyre?</b></p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.01/2017, Neni 7, 1</p>			
14.	<p><b>A përfshin informimi dhe trajnimi i punëmarrësve të gjithë informacionin e kërkuara sipas rregullores?</b></p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.01/2017, Neni 7, 2</p>			
15.	<p><b>A bëhen konsultimet dhe pjesmarrja e të punësuarëve sipas kërkesës së rregullores?</b></p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.01/2017, Neni 8</p>			
16.	<p><b>A janë marrë masa për kryerjen e mbikëqyrjes shëndetësore të punëmarrësve për të cilët vlerësimi i riskut tregon një risk për shëndetin e tyre që rrjedh nga dridhjet?</b></p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.01/2017, Neni 9</p>			
17.	<p><b>A informohen punëmarrësit për rezultatet e mbikëqyrjes shëndetësore, në rastin kur mjeku i punës konstaton se punonjësi ka një sëmundje të identifikueshme apo pasojë negative shëndetësore, që është rezultat i ekspozimit ndaj dridhjeve mekanike në punë?</b></p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.01/2017, Neni 9, 5</p>			

18.	<p><b>A regjistrohen dhe përditësohen të dhënat e mbikëqyrjes shëndetësore për çdo të punësuar, në përputhje me legjislacionin përkatës për mbikëqyrjen shëndetësore?</b></p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.01/2017, Neni 9, 6</p>			
19.	<p><b>A i lejohet punëmarrësit të ketë qasje tek të dhënat e mbikëqyrjes shëndetësore?</b></p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.01/2017, Neni 9, 6</p>			